



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Alfa i." Sh.P.K. të datës 18.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Alfa i." Sh.P.K. e datës 18.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik "Alfa i." Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Alfa i." Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 18.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 13.12.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i therrtores publike" me nr. të prokurimit 616-23-7338-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë se arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit janë arsye të pabazuara. Njëkohësisht parashtruesi pretendon se është tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm me çmimin më të lirë dhe për këtë arsye nuk janë përmbushur kushtet për anulimin e këtij aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se arsyet për eliminimin e parashtruesit nga komisioni vlerësues janë evidentuar si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Edhe pas kërkesës për sqarime, OE prapë nuk e plotëson kriterin për trupin ndriçues për pozicionin 26.5 si më poshtë:

Mungojnë specifikat teknike të detyrueshme për trupin ndriçues. Sipas katalogut të prezantuar nuk ka produkte të cilat e plotësojnë kushtin sipas përshkrimit teknik dhe paramasës në pozicionin 26.5.

-Në katalog është vetëm një lloj i trupit ndriçues të jashtëm produkti "Reflektor", nëse bazohemi tek përshkrimi teknik për trupin ndriçues, fuqia e trupit ndriçues kërkohet të jetë 100W, ky produkt nuk prodhohet sipas prodhuesit me këtë fuqi madje nuk figuron askund në katalog. ---Eficienca kërkohet të jetë 150LM/W ose 15000LM – OE ka prezantuar produktin në katalog me eficiencë nga 163 lm/W nëse i referohemi këtij ndryshimi duke u bazuar në shakallën e shpërndarjes së dritës siq prezentohet 25° 107W 157LM/W (kjo shpërndarje e dritës është e pa përshtatshme për kërkesën në fjalë),

-Temperatura punuese -40°C+ 35°C nuk e plotëson kërkesën specifike teknike të detyrueshme, sepse është kërkuar +50°C,

-IP 65 nuk është në përputhje me kërkesën specifike teknike të detyrueshme e cila duhet të jetë minimum IP 66 një karakteristikë shumë e rëndësishme për trupin ndriçues.

Duhet shtuar se rekomandimi i komisionit vlerësues për eliminimin e parashtruesit nuk është marrë në mënyrë unanime nga komisioni vlerësues për arsye se kryesuesja e komisionit në këtë rast ka prezantuar një mendim të ndarë nga dy anëtarët e tjerë ashtu që ka rekomanduar të shpallet fitues pikërisht parashtruesi i kësaj kërkesë për rishqyrtim operatori ekonomik "Alfa i." Sh.P.K.

1. Sa i përket arsyes së parë, specifika teknike për pozicionin 26.5 lidhur me eficiencën është përcaktuar si vijon "Ndriçuesi i LED-it: ≥ 150 lm/W". Në anën tjetër as ju vet nuk e kontestoni se tenderuesi ka ofertuar 163 lm/w. Mirëpo ndriçuesi nuk kërkohet të jetë 150lm/w sikurse keni thënë ju por është e barabartë ose më e madhe se 150 lm/w. Pra shenja " \geq " lexohet e barabartë ose më e madhe. Kjo nënkupton që kërkesa është plotësuar në tërësi përdërisa tenderuesi ka ofertuar me 163lm/w. Rrjedhimisht nuk qëndron as arsyetimi juaj shtesë ku thuhet se "kjo shpërndarje e dritës është e pa përshtatshme për kërkesën në fjalë".
2. Sa i përket arsyes së dytë, specifika teknike është si vijon "Puna në temperaturë: $\geq -40^{\circ}\text{C}$ deri $+50^{\circ}\text{C}$ ". Në anën tjetër as ju vet nuk e kontestoni se tenderuesi ka ofertuar me "-40°C+ 35°C". Mirëpo nuk kërkohet temperatura "+50°C", sikurse keni thënë ju por është e barabartë ose më e madhe se -40°C deri në 50°C. Pra sërish ju lutem të keni parasysh që shenja " \geq " lexohet e barabartë ose më e madhe. Kjo nënkupton që kërkesa është plotësuar në tërësi përdërisa tenderuesi ka ofertuar me "-40°C+ 35°C" (pra brenda intervalit të kërkuar të temperaturës).
3. Sa i përket arsyes së tretë specifika teknike për mbrojtje ka qenë IP ≥ 66 ndërsa tenderuesi ka ofertuar me IP65. Me fjalë të tjera dallimi është minimal (nuk mund të jetë më i vogël sesa kaq). Prandaj kjo në prokurimin publik trajtohet si devijim i vogël në kuptim të nenit 59 par. 4 të LPP lidhur me nenin 45 par. 19, 20 dhe 21 të RRPP. Pra duke marrë parasysh që të gjitha kërkesat tjera të dosjes së tenderit dhe specifikeve teknike janë përmbushur në tërësi, ndikimi i këtij devijimi është aq i vogël saqë është i papërfillshëm. Me këtë rast ju lutem keni parasysh edhe faktin që ALFA - I është tenderuesi me çmimin më të lirë të ofertuar, ku dallimi me të gjithë tenderuesit tjerë është më shumë se gjysmë milioni euro (500,000.00 euro). Pra ky devijim i vogël pa asnjë ndikim në performancën e projektit duke marrë parasysh diferencën e madhe në çmimet e ofertuar, është me të vërtetë i papërfillshëm, projekti ka të bëjë me "ndërtimin e thetores publike" ndërsa devijimi i vogël është shpërfaqur te pjesa e mbrojtjes së ndriçimit të një pozicion (26.5) të specifikeve teknike në mesin e dhjetëra pozicioneve të tjera të cilat pakontestueshëm janë përmbushur në tërësi. Më poshtë ju lutem gjeni bazën ligjore ku lejohen devijimet e vogla (sikurse kjo për të cilën po bëhet fjalë si shembull eglatant) në prokurimin publik:

Neni 59 par. 4 i LPP: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Neni 45 par. 19, 20 dhe 21 i RRPP:

45.19 - "45.19 Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur".

45.20 - "Mundësia për pranimin e tenderëve, varet nga ajo se çfarë janë "aspektet materiale". Për sa i përket elementeve kontraktuale të dosjes së tenderit, çdo aspekt do të konsiderohet si material, nëse ka mundësi të ndryshojë kushtet e kontratës në lidhje me përshkrimin e cilësisë ose kërkesat e performancës, çmimin ose mënyrën e pagesës, garancinë, sigurimin ose detyrimin dhe sidomos në rastet kur ndryshimi çon në një reduktim të të drejtave kontraktuale të autoritetit kontraktues ose obligimeve të tenderuesit kontraktual. Për sa i përket specifikimeve teknike, është e vështirë në përgjithësi për të dhënë shembullin se çfarë është "materiale". Në një fund të spektrit janë devijime që në realitet janë variante në rastet kur variante të tilla nuk janë të lejuara, shih nenin 29 të LPP-së, këto do të konsiderohen të jenë materiale. Megjithatë, edhe devijimet më të vogla në shumicën e rasteve do të konsiderohen materiale, kur ato ndikojnë për shembull në qëllimin bazë ose kapacitetet funksionale të asaj që kërkohet në bazë të kontratës. Nëse një devijim është material apo edhe çdo devijim tjetër do të varet nga formulimi konkret i dosjes së tenderit. Në disa raste një zgjidhje e propozuar mund të devijojë nga ajo që autoriteti kontraktues e kishte imagjinuar dhe ende të përshihet brenda kushteve të gjera apo të paqarta të dosjes së tenderit. Në këto raste është sigurisht formulimi i dosjes së tenderit dhe jo pritet e autoritetit kontraktues që kanë rëndësi. Njësia matëse është nëse devijimi do të përmendur për të krahasuar tenderët dhe për këtë arsye për të vlerësuar tenderët në mënyrë të barabartë. Siç është përmendur në 45.21 të kësaj rregullore dhe këtij autoriteti kontraktues do të jetë në gjendje të pranojë devijime të vogla në rastet kur devijimet të tilla mund të kuantifikohet".

Neni 45.21 - "Neni 59.4 i LPP-së kërkon që gabimet dhe mangësitë duhet të korrigjohen dhe që devijimet e vogla duhet të kuantifikohen. Gabimet dhe mangësitë janë të ndryshme nga ato aritmetike që trajtohen në nenin 41.9 të kësaj rregullore. Gabimet dhe mangësitë mund të jenë tekstuale ose ato mund të prekin aspekte të tjera të tenderit. Gabimet tekstuale dhe mangësitë duhet të jenë objektive shumë të qarta dhe se autoriteti kontraktues të jetë në gjendje të identifikimit të tyre si gabime dhe mangësi! Çdo paqartësi apo kundërlidhje që nuk mund lehtë të identifikohet si një gabim apo mangësi nuk mund të korrigjohet. Autoriteti kontraktues duhet në raste të tilla të vazhdojë duke kërkuar sqarim në bazë të nenit 59.2 të LPP. Kuantifikimi i devijimeve të vogla ka për qëllim të neutralizimit të efektit që këto devijime do të kenë në krahasimin e tenderëve. Llogaritja duhet të përfundojë duke u shprehur në disa vlera të shprehura në terma monetare".

Duke marrë parasysh faktin se komisioni vlerësues ka qenë në përbërje të tre anëtarëve ku dy prej tyre kanë rekomanduar eliminimin e parashtruesit ndërsa vetëm kryesuesja ka rekomanduar që parashtruesi të shpallet fitues, zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin konstatimeve të shumicës së anëtarëve të komisionit vlerësues. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 26.12.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.